



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorëzuar Primeren / Primita Received / Delivered	26.11.2018	viti god Year
Organ / Rrethi Organ / Jedinica Org / Unit	SKP/SHCK	7156/2018
Shitja Prilog Appendix		111



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 303 /2018

Datë: 15.11.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime për Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Këshilli në mbledhjen e njëzet e tretë (XXIII) të mbajtur më datë 15.11.2018 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet raporti me rekomandime i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme për zbatimin e rekomandimeve në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandim i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme, është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve në pajtim me këtë vendim dhe raportin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Vendimi i dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të Këshillit.

Eshref SHABANI
Kryetar i Këshillit

Page 1 / 1





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punimjano / Prodato Received / Delivery		26 - 11 - 2018		viti god year
Organ / Njësia Org. / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
8PMSACK	7156/2018		1110	

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TE
LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

NË

MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDASHME

PËR

VITIN 2017

Prishtinë, 2018

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	3
Funksioni i mbikëqyrjes.....	3
Objektiva dhe metodologjia mbikëqyrjes.....	3
Fushat e mbikëqyrjes.....	4
Raporti për mbikëqyrjen në Ministrinë e Punëve të Brendshme.....	5
Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve.....	6
Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit.....	6
Procedurat disiplinore.....	7
Procedurat e ankesave.....	7
Procedurat e vlerësimit.....	7
Procedurat e pushimeve.....	8
Procedurat e transferimit.....	8
Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta.....	8
Pezullimi, ndërprerja dhe përfundimi i marrëdhënies së punës.....	9
Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik...9	
Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës.....	9
Trajnimi i nëpunësve civil.....	9
Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet.....	9
Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit.....	10
Shënimet/komentet/ për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.....	10

HYRJJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, Rregullorja Nr. 02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 02/2014 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI MBIKËQYRËS I KËSHILLIT

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike, përmes funksionit të mbikëqyrjes Këshilli bënë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar "Udhëzuesin për procedurën e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil", mbi bazën e të cilit edhe harton "Planin e Mbikëqyrjes" në kuadër të të cilit përfshihen një numër i Institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre Institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim viti.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES

Objektiva e mbikëqyrjes ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MBIKËQYRJES

Këshilli, gjatë implementim të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e mbikëqyrjes në kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të Institucioneve të cilët janë përgjegjës për zbatim të legjislacionit të shërbimit civil.

Në këtë kuadër si pjesë e mbikëqyrjes janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBBIMIN CIVIL NË MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME

Këshilli, gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme për të vlerësuar drejtë, në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Ministria e Punëve të Brendshme, përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës me datë 22.10.2018, në prezencë të Zyrtares së Lartë të Personelit si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Rregulloren (QRK) Nr.36/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Kopjet e Marrëveshjeve me shërbime të veçanta;
- Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2017-Udhëheqës i divizionit të automjeteve;
- Akt emërimi i datës 31.05.2013 për nëpunës administrativ në QKRA-Pejë;
- Akt emërimi i datës 23.08.2013 për nëpunës administrativ në QKRA-Prizren;
- Akt emërimi i datës 31.02.2013 për nëpunës administrativ në QKRC Podujevë;
- Vendimi i datës 13.09.2017 me nr.643 për themelimin e Komisionit Disiplinor;
- Vendimi i datës 08.04.2018 me nr.279 për themelimin e Komisionit për Zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave;
- Vendim për lejin e pagesës së pushimit të lehonisë me nr.720 i datës 12.10.2017;
- Vendim për lejin e pagesës së pushimit të lehonisë me nr.479 i datës 29.06.2017;
- Vendim për lejin e pushimit pa pagesë me nr.20 i datës 24.07.2017;
- Vendim për lejin e pushimit pa pagesë me nr.3059 i datës 15.09.2017;
- Vendim për pensionimin e nëpunësit civil me nr.173 i datës 27.02.2017;
- Vendim për pensionimin e nëpunësit civil me nr.633 i datës 07.09.2017;
- Plani vjetor i trajnimit të nëpunësve civil me nr.157 i datës 22.02.2017;
- Akt emërimi i datës 03.10.2013 Drejtor i Departamentit të Prokurimit;
- Kërkesë për transfer e datës 09.11.2017 ;
- Marrëveshje me nr.854 e datës 16.11.2017 për transferim të përhershëm të nëpunësit civil nga Ministria e Punëve të Brendshme në Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
- Ndryshimi i aktit të emërimit i datës 18.04.2018;
- Vendimi me nr.735 i datës 20.10.2017 për Ushtrues detyre;
- Vendimi me nr. 751 i datës 20.10.2017 për ushtrues detyre;
- Vendimi me nr.48 i datës 08.12.2017 për ushtrues detyre;
- Vendimi me nr.754 i datës 20.10.2017 për ushtrues detyre;
- Vendimi me nr.353 i datës 04.05.2017 për ushtrues detyre;
- Vendimi me nr.360 i datës 05.05.2017 për ushtrues detyre;
- Vendimi me nr.168 i datës 24.02.2017 për ushtrues detyre;
- Vendimi me nr.922 i datës 06.12.2017 për ushtrues detyre;
- Vendimi me nr.339 i datës 28.04.2017 për ushtrues detyre;
- Vendimi me nr.756 i datës 20.10.2017 për ushtrues detyre;
- Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2017;

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në "pyetësor", ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 22.10.2018, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren (QRK) Nr.36/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. Kolegji ka konstatuar se në këtë institucion janë të punësuar 798 nëpunës civil,

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka kontrolluar 5 dosje të nëpunësve civil, respektivisht dosjen personale për pozitat: Nëpunës Administrativ në QKRA-Pejë, Koordinator i QKRA-Prizren, Zyrtar për hulumtim, Nëpunës Administrativ në QKRC Podujevë, Zyrtar i verifikimit të autentifikimit . Gjatë kontrollimit të dosjeve Kolegji i Këshillit ka konstatuar se dosjet ruhen dhe mirëmbahen në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendrorë të Nëpunësve Civilë.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Ministrinë e Punëve të Brendshme gjatë vitit 2017 janë rekrutuar 6 pozita, për te cilat MPB ka zhvilluar procedurat në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil.

Marrëveshjet për shërbime të veçanta: Në Ministrinë e Punëve të Brendshme, gjatë vitit 2017 ka pasur njëmbëdhjetë (11) të punësuar me marrëveshje për shërbime të veçanta.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka shqyrtuar mostrat e të gjitha kontratave për shërbime të veçanta, dhe pas vlerësimit ka konstatuar se katër (4) të punësuar me marrëveshje për shërbime të veçanta janë angazhuar në pozitat e nëpunësve civil. Kolegji konstaton se në bazë të nenit 12 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ekzistojnë dy kategori të punësuarave: "*pozitat e nëpunësve civilë të karrierës dhe pozitat e nëpunësve civilë të jo karrierës*", andaj në kuptim të kësaj, në pozitat e nëpunësve civil nuk mund të angazhohen persona me kontrata për marrëveshje për shërbime të veçanta, sepse për pozitat e nëpunësve civilë duhet shpallur konkurs për nëpunës civil me afat të caktuar (nëpunës jo të karrierës) dhe afat të pacaktuar (nëpunës civil të karrierës), Kolegji konstaton se personat e angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta duhet të angazhohen për punë specifike në pajtim me dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore.

Po ashtu Kolegji ka konstatuar se Ministria e Punëve të Brendshme me rastin e lidhjes së këtyre kontratave nuk ka aplikuar zhvillimin e një procedure të thjeshtësuar të rekrutimit, ashtu siç kërkohet me legjislacionin në fuqi, andaj Kolegji konstaton se në këto raste është vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 12 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe nenit 18 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm dhe Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme që të bëjnë eliminimin e shkeljeve dhe që pozitave të lira të nëpunësve civil të plotësojnë në pajtim me nenin 12 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e jo të bëhet angazhimi i personave në bazë të kontratave për shërbime të veçanta, ndërsa në rastet e angazhimit të punonjësve përmes kontratave për shërbime të veçanta të zbatohet dispozitat e nenit 12 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe nenin 18 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, duke aplikuar një procedurë të thjeshtëzuar të rekrutimit.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Punëve të Brendshme Komisionin Disiplinor e ka të themeluar në bazë të Vendimi i datës 13.09.2017 me nr.643 në pajtim me nenin 70 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2017 në Ministrinë e Punëve të Brendshme nuk është zhvilluar asnjë procedurë disiplinore ndaj nëpunësve civil.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Punëve të Brendshme Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e ka themeluar në bazë të Vendimit të datës 08.04.2018 me nr.279, e që është në pajtim me nenin 82 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit 2017 Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ka zhvilluar 44 procedura për shqyrtimin e ankesave, të gjitha procedurat janë shqyrtuar nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, njëzetën (21) vendime janë atakuar me ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, i cili 20 i ka refuzuar si të pabazuara ndërsa një ankesë është tërhequr ankuesja, duke konstatuar se me rastin e nxjerrjes së këtyre vendimeve komisioni ka arritur që të vlerësojë drejtë gjendjen faktike dhe juridike lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka shqyrtuar dosjet e nëpunësve civil lidhur me vlerësimet vjetore të punës, dhe ka gjetur se:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka gjetur se Ministria e Punëve të Brendshme për vitin 2017 nuk ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për nëpunësit civilë në pozitave të nivelit drejtues, respektivisht nuk ka vlerësuar tridhjet e nëntë (39) nëpunës civilë të kësaj kategorie, në këtë rast mos vlerësimi i rezultateve të punës për të gjithë nëpunësit civil është shkelje e dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe me dispozitat nenin 3 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civilë, sepse

moskryerja e vlerësimit mund të përbëjë shkak për fillimin e procedurës për masë disiplinore sipas nenit 33 paragrafit 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme që vlerësimin e rezultateve në punë për nëpunësit civil ta bëjë në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civilë.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Ministrinë e Punëve të Brendshme evidencën e pushimeve të nëpunësve civil e mban në kopje fizike dhe elektronike. Gjatë vitit 2017 në Ministrinë e Punëve të Brendshme janë realizuar 760 pushime mjekësore, 5 pushime pa pagesë dhe 11 pushime të lehonisë. Të gjitha procedurat janë zhvilluar në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civilë.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civilë, ka konstatuar se në Ministrinë e Punëve të Brendshme gjatë vitit 2017 janë zhvilluar 9 procedura të transferimit të nëpunësve civilë, prej tyre 7 të brendshme e 2 të jashtme. Të gjitha procedurat janë zhvilluar në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civilë.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Punëve të Brendshme, ka të punësuar 798 nëpunës civil nga ta sipas strukturës gjinore janë 349 femra, ndërsa 449 mashkuj, sipas strukturës etnike 733 janë shqiptarë, 51 serbë, 3 boshnjakë, 1 goranë, 3 romë dhe 7 turq. Sa i përket personave me nevoja të veçanta, Kolegji konstaton se në Ministrinë e Punëve të Brendshme janë të punësuar katër (4) nëpunës civilë me nevoja të veçanta.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 798 nëpunësve civilë të punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, 349 prej tyre janë femra ndërsa 449 janë meshkuj, çka nënkupton se nuk ka numër të barabartë të punësuarve ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

Po ashtu Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 798 nëpunësve civil të punësuar, janë vetëm katër (4) të punësuar me nevoja të veçanta, me çka konstatohet se nuk është respektuar numri i të punësuarve të personave me nevoja të veçanta në institucion, ashtu siç përcaktohet me dispozita e nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, pasi që çdo punëdhënësi është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtorë.

Rekomandim 1: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të ndërmarr të gjitha veprimet që me rastin e shpalljeve publike të procedurave të rekrutimit të kujdeset që të zbatohen dispozitat e nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, si dhe dispozitat e nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Ministrinë e Punëve të Brendshme gjatë vitit 2017 shtatë (7) nëpunës civilë kanë qenë me pezullim të dakorduar për shkak të marrjes së detyrës së funksionarit publik, nëntë (9) nëpunës civil kanë përfunduar marrëdhënien e punës për shkak të dorëheqjes, nëntë (9) nëpunës civilë kanë përfunduar marrëdhënien e punës me arritjen e moshës e pensionimit, dhe dy (2) nëpunës civil u është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të vdekjes. Kolegji konstaton se në të gjitha rastet Ministria ka zbatuar dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Ministrinë e Punëve të Brendshme gjatë vitit 2017 ka pasur 7 nëpunës civil të emëruar në funksione publike, të cilëve u është pezulluar mardhënien e punës në pajtim me nenin 89 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Kolegji konstaton se nuk ka pasur asnjë nëpunës civilë i cili ka ushtruar ndonjë funksion që bie në papajtueshmëri me ushtrimin e pozitës së nëpunësit civil.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme gjatë vitit 2017 nuk është zhvilluar asnjë procedurë penale ndaj nëpunësve civil.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Punëve të Brendshme për vitin 2017 ka hartuar "Planin e trajnimeve" i cili me datën 22.02.2017 i është dërguar MAP-it. Tridhjetë e gjashtë (36) nëpunës civilë kanë ndjek trajnimet në IKAP.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Punëve të Brendshme, vijimin në punë e mban në formë

elektronike. Në bazë të aprovimit nga Ministria e Financave dhe Ministria e Administratës Publike, Ministria e Punëve të Brendshme për njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë (169) nëpunës civilë të punësuar në ARC dhe AME jep shtesat për rrezikshmëri në punë, tridhjetë (36) nëpunës civilë marrin shtesat mbi bazën e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për pozitat e teknologjisë informative, e po ashtu mbi bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës shtesat në punë marrin edhe gjashtë (6) nëpunësit civilë në Departamentin e Integritetit Evropian. Kolegji, konstaton se të gjitha këto shtesa janë në pajtim me vendimet dhe aprovimet e lartëcekura.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

14. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, vlerëson se në vitin 2017 Ministria e Punëve të Brendshme ka qenë subjekt i monitorimit për vitin 2016, ku i janë dhënë gjashtë (6) rekomandime. Kolegji gjatë shqyrtimit të dosjes së raportit monitorues ka gjetur se tri (3) prej rekomandimeve të dhëna në vitin 2017 nuk janë zbatuar nga institucioni.

Rekomandim 1: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë të Punëve të Brendshme që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve të Këshillit ashtu siç përcaktohet me nenin 21 të Ligj Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ndërsa sa i përket obligimit për zbatim të vendimeve të Këshillit, Kolegji konstaton se Ministria e Punëve të Brendshme për vitin 2017 nuk ka pasur për obligim zbatim të vendimeve pasi që të gjitha asnkemat e ardhura nga MPB janë refuzuar me vendime të Këshillit.

15. SHËNIMET/KOMENTET PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes, ka konstatuar katër (4) të gjetura dhe ka dhënë katër (4) rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që *gjetjet me rekomandimet* e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

I dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udheheqesit të Burimeve Njerzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK

Hajzer Salihu
Kryetar i Kolegjit

Sabile Avdyli
ZL për Bashkëpunim Profesional



Sabile Avdyli